# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-440797**

VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Emërimi i Yllka Kukalajt në OSHISH, Spahiu i përgjigjet kritikave: Menaxhere shumë e mirë, opozita numëron kushërinjtë |
| ADRESA | `https://prapaskena.com/2026/09/13/emerimi-i-yllka-kukalajt-ne-oshish-spahiu-i-pergjigjet-kritikave-menaxhere-shume-e-mire-opozita-numeron-kusherinjte/` |
| BURIMI | prapaskena.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 13 shtator 2026, 19:05:52 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 13 shtator 2026, 17:08:21 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `eeb7decb5ac389af6579e923c27d36a2b21922730ad5c8c800d769d8903755df` |
| TEKSTI | `d878e017ba316f537ce9d1f47b09ef3022dcb55bc5d0e4a8cfef324e03d88ee5` |
| PAMJA | `0f64b130867429e41961027782ee3b070a708f188137f551aa634795ee75b476` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `d818d67c61614d0e1c889ebcc8d788fdd413f82a409da55d90ba3273d6386495` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `189cdded276785f170fe9cc7ce5e87625aab0e70d3bc68c5e8e7b4173c15ebbc` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/d818d67c61614d0e1c889ebcc8d788fdd413f82a409da55d90ba3273d6386495`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Emërimi i Yllka Kukalajt në OSHISH, Spahiu i përgjigjet kritikave: Menaxhere shumë e mirë, opozita numëron kushërinjtë

Politikë

Publikuar: 13/09/2026




Ministrja e Shëndetësisë, Klodiana Spahiu, ka reaguar pas pyetjeve të ngritura nga Bardh Spahia për emërimin e Yllka Kukalajt në drejtim të OSHISH.

Spahiu mbrojti zgjedhjen duke renditur eksperiencën e Kukalajt në administrimin e financave dhe drejtimin e spitalit të Krujës, ndërsa hodhi poshtë kritikat që e lidhin emërimin me marrëdhënie familjare. Sipas saj, drejtuesit do të gjykohen për punën dhe jo për "pemën gjenealogjike".

**Reagimi i plotë i Ministres së Shëndetësisë:**

*Z. Bardh Spahia ka pyetur publikisht për emërimin e Yllka Kukalajt. Ka të drejtë të pyesë. Unë kam detyrë të përgjigjem.*
*Pse Yllka Kukalaj?*
*Sepse në atë detyrë nuk më duhet dikush që ta mësojë punën. Më duhet dikush që e njeh atë.*
*Yllka Kukalaj është ekonomiste. Ka drejtuar sektorin e buxhetit dhe pagave në bashkinë e Krujës, pastaj spitalin e qytetit, për vite, si titullare e autoritetit kontraktor.*
*Në atë spital ishte kur ra tërmeti, kur erdhi pandemia, kur u rindërtua godina dhe aty e kam njohur në punë.*
*Kush e ka kaluar këtë rrugë të shërbimit e di sa kushton një shtrat dhe sa kushton një pajisje.*
*Atyre që thonë se Yllka Kukalaj qenka "anonime" i them po, me siguri është anonime për kafenetë politike të Tiranës. Nuk është anonime për spitalin që ka drejtuar, për mijëra pacientët që janë shërbyer dhe për peshën e madhe të përgjegjësisë që ka mbajtur përsipër.*
*Për kushërirat: ka një mënyrë shumë të vjetër për t'i goditur*

Me te lexuarat


Rama "djeg" Allajbeun, i heq tenderin 50 milionë euro për sterilizimin në minutat e fundit, Spahi...


...dha tender Besnik Leskajt pasi Leskaj i mori në punë të birin. Postet në administrat...


I tmerrshmi i Beratit / Si ra Lulzim Caka në prangat e policisë greke për trafik kokaine, saga e...


Porolli padit Ramën në Arbitrazh: Po na merr aeroportin e Vlorës për t'ia dhënë biznesmenit izrae...


Emri i ri, borxhi i vjetër: si lind ASHP-ja me gjysmën e ATP-së akoma gjallë brenda saj

*gratë që marrin një detyrë publike.*
*Zhduket karriera profesionale dhe fillon gjurmimi në pemën gjenealogjike.*
*Burrave u numërohen heroizmat. Grave u numërohen kushërinjtë.*
*Kjo nuk është mënyra ime.*
*Yllka Kukalaj do të gjykohet për atë që bën në OSHISH, si çdo drejtues tjetër që do të emëroj.*
*Me mua profesionisti vjen përpara paragjykimit dhe qytetari vjen përpara koncesionit.*
*Prandaj Yllka Kukalaj në drejtim dhe prandaj edhe rishikimi i imët i një procedure të gjetur të hapur mbrapsht.*
*Këtë metodë di. Për këtë metodë kam ardhur. Nga kjo metodë nuk heq dorë!*






## Prapaskena

‘Prapaskena’ lindi si një nismë e një grupi gazetarësh me përvojë dhe plotësisht të pavarur nga çdo parti politike, grup interesash apo klane biznesi, me qëllim për të thënë çdo të vërtetë të guximshme me interes publik. ‘Prapaskena’ është një media e lirë dhe e pakompromis, e cila ka si qëllim informimin e opinionit publik në mënyrë të paanshme, profesionale dhe në dritën e të vërtetës, mbi çështje që lidhen me korrupsionin politik, krimin, pandëshkueshmërinë, grabitjen e pasurive publike, mbi reformat, sfidat kombëtare dhe lidhjet e padukshme mes partive politike, mediave të njësuara me interesat klienteliste, krimit dhe biznesit jo të ndershëm, të cilët në bashkëpunim përvetësojnë paratë dhe pasuritë publike.’

## Copyrights

Çdo kopjim, përdorim apo riprodhim i paautorizuar i këtij materiali është i ndaluar dhe mund të sjellë ndjekje ligjore. Ju lutemi respektoni punën dhe përpjekjen tonë duke mos e shkelur këtë parim.




Email: [email protected]

Copyright © 2025. All Rights Reserved by Prapaskena
Privacy Policy | Cookies

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.